

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01&03.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "R&RUKOLLI" për aktivitetin: "Rrethrotullimi Lakerishtë-Rrethrotullimi Arbëri" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-3326-512 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "R&Rukolli" e datës 01&03.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Rrethrotullimi Lakerishtë-Rrethrotullimi Arbëri ", me nr.616 18 3326 512 dhe nr. Brendshëm 616 18 010 512 kundër Njoftimit të Vendimit për dhënie të kontratës të AK -së, të datës 27.11.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi i Vendimit për dhënie të kontratës i publikuar me datë: 27.11.2018;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "R&Rukolli" me datë 01&03.12.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrethrotullimi Lakerishtë-Rrethrotullimi Arbëri" me Nr.616 18 3326 512 Nr. Brendshëm 616 18 010 512". Autoriteti Kontraktues, me datë 03.12.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimet për shkeljen e nenit nuk janë të bazuara, pasi që asnjë kërkesë e veçantë nuk është paraqitur për ndonjë nga tenderuesit, e cila do të mund ta diskriminonte apo favorizonte ndonjerin prej tyre;
2. Pretendimet për shkeljen e 59 poashtu janë të pa qëndrueshme, pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve janë respektuar kërkesat e FDT-së dhe janë trajtuar në mënyrën e njëjtë të gjithë tenderët; dhe

3.Pretendimi lidhur me çmimet jonormalisht të ulta është pjesërisht i bazuar dhe këtë Autoriteti Kontraktues dhe udhëheqësi i prokurimit e kanë vërejtur me kohë dhe kanë kërkuar sqarime sipas nenit 61 dhe Rregullave për tenderët jonormalisht të ulët,mirëpo sipas Vendimit të OSHP-së si që jeni njoftuar edhe ju shumica prej atyre çmimeve janë konsideruar si çmime reale.Unë edhe më tutje kam bindjen se kam vepruar në harmoni me dispozitat ligjore kur kam kërkuar sqarimet dhe kur nuk kam pranuar si të mjaftueshme sqarimet e dhëna nga OE-ik "RSM".

Poashtu ju sqaroj se edhe përkundër bindjes time unë jam i detyruar të respektoj Vendimin dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së,sipas të cilave OE-ik "RSM"ka dhënë sqarime të pranueshme dhe sipas kësaj tenderi i tij del të jetë i përgjegjshëm.

Bazuar në Vendimin e OSHP-së edhe përkundër mospajtimeve të mija kam aprovuar rekomandimin e komisionit,por sipas vërejtjeve të mija që janë shënuar edhe në raportin e rivlerësimit.

Pasiqë ndryshimi i rekomandimit tonë paraprak ndërlidhet me Vendimin e OSHP-së,ju lutem që lidhur me pa kënaqësitë tuaja t'i drejtoheni atij Organi.

Bazuar në sqarimet e cekuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit